

DEKLARATË DHËNIE PËLQIMI

Në vijim të pranimit të kushteve të punës për përdorimin e platformës FINARCH, **deklaroj vullnetarisht të dhënat e mia**: emër, mbiemër, numri i telefonit, adresë emaili, adresa, informacion mbi punësimin, të ardhurat mujore nga punësimi, me qëllim që të përpunohen më tej nga FINARCH në funksion të marrjes së shërbimeve të ofruara në platformën FINARCH.

Lejoj Finarch që të dhënat e mia, të deklaruara në platformë, **të ruhen nga FINARCH për një afat deri në 2 muaj nga momenti i deklarimit**, në funksion të marrjes së shërbimeve të lartëpërmendura.

Autorizoj FINARCH që të fshijë të dhënat në përfundim të këtij afati.

Jap pëlqimin tim që:

1. FINARCH të më kontaktojë me qëllim që të më suportojë nëpërmejt kanaleve të veta të komunikimit, për të realizuar me sukses aplikimin në platformën Krahasesi i Kredive Hipotekore.
2. FINARCH të përdorë të dhënat e mia personale për marketing direkt, informim me qëllimin e përfitimit nga ana ime të ofertave promotionale, duke përfshirë por pa u kufizuar në: i) postë zyrtare ii) sms iii) telefonatë iv) postë elektronike.
3. FINARCH të shkëmbejë të dhënat e mia personale me partnerët kontraktues për të përmbushur qëllimet e përpunimit.

Jam i qartë se :

- Me dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave të deklaruara nga ana ime do të kem mundësi ta përdor platformën FINARCH.
- Në cdo moment pasi si përdorues kam dhënë vullnetarisht informacionin e kërkuar në këto fusha specifike, më lind e drejta që, të kërkoj pranë FINARCH akses në këto të dhëna si dhe të kërkoj, bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e tyre në përputhje me parashikimet e bëra në Ligjin nr.9887 dt.03.10.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, zëvendësuar me Ligjin nr.124/2024 datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe GDPR.
- Dizenjimi i ofertave individuale do të bëhet nëpërmjet procesit të profilizimit që përfshin analizë të automatizuar të dhënave personale për të konkluduar mbi nevojat ekonomike ose financiare, përgjegjësinë time financiare dhe karakteristika të tjera të cilat analizohen për të krijuar ofertat individuale.
- Nuk jam i detyruar të jap pëlqimin tim për opsionet e ofruara në këtë deklaratë dhe kam të drejtë të tërheq pëlqimin në çdo kohë. Në atë rast të dhënat e mia personale nuk do të përdoren më për qëllimet e dhënies së shërbimeve në FINARCH.
- Për cdo ankesë lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, mund t’i drejtohem “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale”.